

AKT NORMATIV
Nr. 10, datë 24.3.2021

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË NËNSHKRUAR NDËRMJET
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, MINISTRIT TË
SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK,
DHE DISTRIBUTORIT TË AUTORIZUAR “KEYMEN ILAÇ SANAYI VE
TICARET” A.Ş. PËR FURNIZIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ME
VAKSINËN E INAKTIVIZUAR KUNDËR COVID-19 (VERO CELL), CORONAVAC,
TË KRIJUAR NGA SINOVAC LIFE SCIENCE CO LTD. DHE TË PRODHUAR NË
REPUBLIKËN POPULLORE TË KINËS**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Miratimi i marrëveshjes së nënshkruar

Miratimin e marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, dhe distributorit të autorizuar “*Keymen Ilaç Sanayi ve Ticaret*” A.Ş. për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinën e inaktivizuar kundër COVID-19 (*vero cell*), *Coronavac*, të krijuar nga *Sinovac Life Science Co Ltd.* dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës, sipas tekstit bashkëlidhur këtij akti normativ.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama